

AKT THEMELIMI & STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"VO&GE" SH.P.K

Neni 1

Emërtimi i shoqërisë

1.1 Shoqëria e emërtuar "VO&GE" shpk (më poshtë e quajtur "Shoqëria,,) është një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar e themeluar dhe që ekziston me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

1.2 Shoqëria është themeluar sipas ligjit nr.9901. datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar.

NENI 2

Selia e Shoqërisë

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Durrës , Pasuria nr.27/77 N-20,Zona kadastrale Nr.8512 Volumi 35 faqe 140

2.2 Shoqëria mund të hap zyra perfaqësimi ,degë dhe /ose filiale të marë pjesë në shoqëri të tjera , të kryejë aktivitete në vende të tjera brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet eAsamblese se pergjithshme te Ortakeve,qe mund te miratohen here pas here.

NENI 3

KOHEZGJATJA

3.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar ,duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.



NENI 4

Objekti i shoqerise

4.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise "VO&GE" shpk eshte "Tregti e artikujve te ndryshem veshjesh ,importi dhe eksporti i tyre" eshte:

4.2 Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimtari tjeter tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj.

NENI 5

5.1 Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit , te shtoje ortkaket, te rrise ose zvogeloje kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie.

NENI 6

6.1 Kapitali i nenshkruar dhe teresisht i shlyer i shoqerise eshte 100.000 (Njeqind mije) leke, i cili do te paguhet , me celjen e llogarise se shoqerise , menjehere pas regjistrimit ne QKB.

6.2 Kapitali i shoqerise zoterohet si meposhte :

a) Kontributi ne para i kapitalit te shoqerise qe zoterohet nga Z. Renato Gega, eshte 1 kuote e barabarte me 100.000 leke (100% te kapitalit te shoqerise).

6.3 Pergjegjësia e ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e shoqerise .

NENI 7

Zmadhimi i kapitalit

Kpitali i shoqerise mund te rritet ne te ardhmen, nepermjet nenshkrimet dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortaket e rinj, vetem me vendim unanim te Asambles se Ortakeve, ku do te miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakeve te rinj. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te gjithe ortakeve.

NENI 8

Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit te shoqerise do te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e vecanta qe parashikohen nga Ligji 9901. date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"



NENI 9

Transferimi i kuotave dhe e drejta e perparise

Kuotat e cdo anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e shoqerise jane te transferueshme midis ortakeve te shoqerise ose te treteve ne cdo kohe gjate kohezgjatjes se aktivitetit te shoqerise. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise.

Nese ndonje nga ortaket deshiron te tranferoje ose te shese nje pjese ose te gjitha kuotat e tij atehere ai duhet t i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e blesit. Administratori jep pergjigje brenda 30 diteve nga data e njoftimit dhe duhet t ua transmetoje ortakeve te tjere ketq kerkese dhe ortaket e tjere duhet te japin nje pergjigje brenda 3muajve . Edhe e drejta e perparise per transeferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

NENI 10

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

10.1 Funksonet dhe Kompetencat

10.1.1 Neperputhjen melegjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e thirrur rregullisht,perfaqeson te gjithte Ortaket e shoqerise dhe eshte organi me i larte vendimarres i shoqerise. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendimet e meposhtme ,por pa u kufizuar vetem ne to :

- a) Percaktimin e politikave te biznesit;
- b) Emerimin dhe shkarkimin e Administrarit (eve);
- c)Emerimin dhe shkarkimin e likuiduseve dhe eksperteve kontabel;
- d)Rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- e)Zbatimin dhe miratimin e pasqyrave finaciare per llogarite vjetore, te administrimit dhe te raporteve te mbikqyrjes;
- f)Miratimin e rregullave proceduriale ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Ortakeve ;
- g)Miratimin e shperndarjes se fitimit vjetor;
- h)Miratimin e skemes se kompesimit per Administratorit,Likuiduesin,dhe ekspertet kontabel;
- i)Ristrukturim,prishjen,transformimin,bashkimin,likujdimin e shoqerise ose riorhanizimin e Shoqerise ne ndonje forme tjeter Shoqerie;
- j)Marrjen e te gjitha masave me qellim qe te sigurohet qe Shoqeria te kete kapital dhe asetete mjaftueshme per ushtrimin e aktivitetit dhe permbushjen e detyrimeve kundrejt te treteve;
- k)Krijimin,mbylljen dhe/ose prishjen e degeve,zyrave te perfaqesimit dhe filialeve;
- l)Cdo ceshtje tjeter qe percaktohet nga ligji dhe nga ky statut;



Cdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese, me te drejten e votes ne raport me numrin e kuotave te zoteruara ne kapitalin e Shoqerise. Cdo ortak mund te oerfaqesohet ne vendimarrje nga cdo person, me kusht qe perfaqesuesi te jete i pajisur me prokure per kete qellim.

10.2 Thirrja e Asamblese

10.2.1 ASambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nga administratori sipas gjykimit te tij te lire ose me kerkesen e nje dhe ose me shume apo nga ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te shoqerise,dhe/ose eksperti kontabel i autorizuar, nese ka dhe ose likujduesit. Ortakeve duhet tu dergohet nje njoftim me shkrim per m,bledhjen me ane te postes se regjistruar apo me e-mail, jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes,vendin,daten dhe oren e saj.

10.2.2 Verifikimi i njoftimit te mbledhjes nuk eshte i nevojshem nese te gjithe Ortaket jane te pranishem apo jane te perfaqesuar , ne perputhje me nenin 10.1:2.

10.3 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

10.3.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji ,statuti dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

10.3.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet nese:

a)rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare;

b)shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive,te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

c)shoqeria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

10.3.3 Asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese , duke miratuar apobere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

10.4 Kuorumi

10.4.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve , qe kerkojne nje shumicee te zakonshme ,Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendimet te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

10.4.2 Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceashtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar ,ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese , apo mjete elektronike.

Marrja e vendimeve

10.5.1 Asambleja e Pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesmarres ne rastet kur kerkohet:

- a) ndryshimi i statutit
- b) zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar,
- c) shperndarja e fitimeve riorganizimi,
- d) prishja e shoqerise

10.5.2 Me perjashtim te rasteve te parashikuara sa me sipër ne piken 10.5.1 per te gjitha pikat e tjera te percaktuara ne piken 10.1.1, Asambleja e Pergjithshme do te vendose me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres.

NENI 11


Administrimi i Shoqerise

11.1 Shoqeria do te administrohet nga 1 (nje) Adiministrator, qe do te emerohen me vendim te Asamblese se Ortakeve. Adiministratori i vetem i shoqerise emerohet Z. Renato Gega, Adiministratori do te merohet perkatesisht per nje periudh kohore prej 5 (pese vite), duke filluar nga data e themelimit.

11.2 Adiministratori do te jete pergjegjes per administrimin frytdhenes, te dobishme e te kujdesshem te shoqerise dhe do te perfaqesoje shoqerine kundrejt paleve te treta ne lidhje dhe ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe/ose te ligjit/eve te zbatueshme. Adiministratori kane kompetenca te plota per administrimin e zakonshem ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe per administrimin e jashtezakonshem te Shoqerise, te cilat do te percaktohen me vendim te Ortakeve, pervec atyre kompetencave te cilat ushtrohen nga organet e tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjit/eve te zbatueshme

11.3 Adiministratori do te kete kompetenca dhe detyra qe lidhen me administrimin dhe mbikqyrjen e aktivitetit te Shoqerise, si me poshte vijon:

- a) te mbikqyre dhe te zbatoje veprimtarite dhe politikat tragtare te shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve;
- b) Te propozoje vendimet qe do te miratohen nga Asambleja e Ortakeve dhe ti zbatojne keto vendime .
- c) Te sigurojne qe shoqeria respekton ligjin (et) e zbatueshme dhe standartet tregtar te shoqerise;
- e) Te perfaqesoje Shoqerine kundrejt te treteve;
- f) Te siguroje qe dokumentet dhe librat kontabel te shoqerise te mbahen ne rregull dhe me saktesi;
- g) Te therrase nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme kur e vleresojne te nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;
- h) Te pergatise dhe nen shkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise , pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat bashke me propozimin per shperndarjen e fitimit i paraqiten per miratim Asamblese se Ortakeve;



pejne te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine , sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshem.

j) T i raportoje ne Mledhjen e Asamblese se Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe , nese lryhen aktivitetet tregtare me vlere te vecante, te raportoje ne Asamblen e Ortakeve ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise.

11.4 Administratori mund te suhtroje te gjitha kompetencat e Shoqerise si dhe te kryje te gjitha veprimet qe me ligj ose per arsye te tjera nuk jane kompetence e Asamblese se Pergjithshme , ose nuk kufizohen nga ky statut.

11.5 Administratori ka te drejte te ndermarre ne emer te Shoqerise dhe/ose te perfshije Shoqerine ne transaksione, marreveshje ose aktivite ne dobi te shoqerise.

11.6 Administratori eshte pergjegjes kundrejt Shoqerise dhe/ose paleve te treta per demet e shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij statuti ose ligjeve te zbatueshme.

NENI 12

Marredheniet e punes

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojte rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkatkojne kesaj Shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

NENI 13

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratoret e kesaj shoqerie.

NENI 14

Ekspertet kontabel te autorizuar

Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne rastet kur parashikohet ne legjislacion shqiptar.

Kontrrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet.

Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

NENI 15

Bilanci dhe fitimet

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne date 31 dhjetor te cdo viti . Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim-humbje dhe inventar. Pasi vecaohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

NENI 16

Shperndarja dhe prishja e shoqerise

16.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Shperndarja do te ndiqet nga prishja e saj.

16.2 Ne rast se shoqeria priset per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakve percakton menyren e likujdimit , emeron nje ose me teper likujdator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar .

16.3 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik vetem per qellime qe lidhen me likujdimin dhe emerimin e shoqerise gjate fazes se likujdimit do te ndiqet nga fjalet ne proces likujdimi.

NENI 17

Ligji i zbatueshem

17.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me dispozitat e ligjeve shqiptare te zbatueshme.

17.2 Per cdo rast, aspekt apo ngjarje qe nuk percaktohet nga ky statut , do te aplikohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shqerite tregtare".

NENI 18

Mosmarreveshjet

Cdo mosmarreveshje qe nuk mund te lind ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e ketij Stauti , si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te lind midis Shoqerise Dhe paleve te treta, do te zgjidhet nga gjykata kompetente.

NENI 19

Ndryshimet

19.1 Stauti i shoqerise mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht apo teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Edo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerr ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky statut nenshkrhet rregullisht nga ortaket e shoqerise ne Durres sot, me 13/10/2020

Asambleja e Ortakeve

Renato Gega

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, stylized initial 'R' followed by a vertical line and a small flourish at the bottom.